

VENDIM
Nr.140, datë 29.3.2007

PËR DHËNIE FONDI PËR BLERJE APARTAMETESH BANIMI, NË NDIHMË TË FAMILJEVE TË RREZIKUARA NGA SHEMBJA E PALLATIT NË LAGJEN “DUKAS” NË BASHKINË PATOS TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”, dhe të neneve 31 e 32/a të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë Patos të qarkut të Fierit, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i jepet një fond shtesë prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për familjet, që banojnë në pallatin në lagjen “Dukas”, të kësaj bashkie, i cili rrezikon të shembet.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Emrat e kryefamiljarëve të familjeve, që do të përfitojnë nga ky fond, janë sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Familjet, që përfitojnë nga ky vendim, përpara se të tërheqin shumën përkatëse për blerjen e apartamenteve në tregun e lirë, detyrohen të bëjnë kalimin e pronësisë së banesës së vjetër dhe të trullit nën sipërfaqen e ndërtimit, në pronësi të bashkisë së Patosit.

5. Ngarkohet bashkia e Patosit, që, pas lirimit të plotë të pallatit nga familjarët, në përputhje me rregullat, financiare dhe teknike, të marrë masa për prishjen e ndërtesës.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, prefekti i qarkut të Fierit dhe bashkia e Patosit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

LISTAT E KRYEFAMILJARËVE TË FAMILJEVE, BANORË NË PALLATIN E RREZIKUT NGA SHEMBJA NË LAGJEN “DUKAS” TË BASHKISË PATOS, QARKU FIER

Nr.	Emër	Atësia	Mbiemri	Sipërfaqja që disponon	Fondi që i akordohet në 000/lekë
1.	Ektor	Aris	Metaj	74 m ²	1 250
2.	Vasil	Koli	Golloshi	74 m ²	1 250
3.	Rauf	Riza	Hoxhaj	74 m ²	1 250
4.	Xhevat	Kodhel	Bregu	74 m ²	1 250
5.	Haxhi	Rrapo	Nuhaj	74 m ²	1 250
6.	Faslli	Rexhep	Shpata	74 m ²	1 250
7.	Sile	Sotir	Marko	74 m ²	1 250
8.	Sulo	Mete	Murataj	74 m ²	1 250
				Totali	10 000